



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ___/2019

PËR ARBITRAZHIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITATË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

1. Ky ligj rregullon arbitrazhin vendas dhe arbitrazhin ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë, organizimin dhe zhvillimin e procedurave të arbitrazhit, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të arbitrazhit vendase dhe të huaja, si dhe juridiksionin dhe kompetencat e gjykatavembiprocedurat e arbitrazhit në përputhje me legjislacionin procedural civil në fuqi.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka si qëllim:
- të krijojë kuadrin ligjor për organizimin dhe zhvillimin e procedurave të arbitrazhit;
 - të sigurojë ofrimin e arbitrazhit në mënyrë profesionale, cilësore, efëçente dhe efektive;
 - të sigurojë mirëorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e organeve përgjegjëse për ofrimin e arbitrazhit.

Neni 3

Përkufizime dhe rregulla interpretimi

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “*arbitrazh*” është;çdo procedurë arbitrazhi pavarësisht nëse administrohet ose jo nga një institucion arbitrazhi;
- b) “*arbitër*” është një person i vetëm ose si pjesë e një trupi gjykues arbitrash, i përzgjedhur në përputhje me parashikimet e këtij ligji, për të shqyrtuar mosmarrëveshjen midis palëve të përfshira në procedurën e arbitrazhit;
- c) “*arbitrazh vendas*” është procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjes në të cilën:
 - (i) palët në marrëveshjen e arbitrazhit, në kohën e arritjes të marrëveshjes, kanë seli qendrore në Republikën e Shqipërisë; dhe
 - (ii) vendi i caktuar për zhvillimin e Arbitrazhit, sipas marrëveshjes të Arbitrazhit, është Republika e Shqipërisë.
- ç) “*arbitrazh ndërkombëtar*” është procesi i zgjidhjes së një mosmarrëveshje në të cilën:
 - i) palët në kohën e lidhjes së marrëveshjes së arbitrazhite kanë vendin e ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare në shtete të ndryshme;;
 - ii) vendi i arbitrazhit, kur ky është i përcaktuar në marrëveshjen e arbitrazhit ndodhet jashtë shtetit në të cilin palët kanë të regjistruar selitë e tyre; ose
 - iii) palët kanë rënë dakord shprehimisht se objekti i marrëveshjes së arbitrazhit ka lidhje me më shumë se një vend.
- d) “*gjykatë*” është një organ i sistemit gjyqësor të Republikës së Shqipërisë.
- dh) “*gjykata e arbitrazhit*” është një organ i posaçëm i caktuar nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit me qëllim gjykimin e mosmarrëveshjes ndërmjet tyre;
- e) “*marrëveshje arbitrazhi*” është marrëveshja midis palëve për të zgjidhur me arbitrazh të gjitha ose disa mosmarrëveshje që kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre në lidhje me një marrëdhënie juridike.
- ë) Për efekt të zbatimit të këtij ligji termi “tregtar” ka kuptimin e çështjeve që rrjedhin nga të gjitha marrëdhëniet e natyrës tregtare qofshin këto kontraktuale ose jo duke mos u kufizuar vetëm në to si transaksionet tregtare për furnizimin ose shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve, kontratat e speditonit, përfaqësimit ose agjencive tregtare, dhënies me qira; këshillimit, licencimit, investimeve, financimit, veprimit bankar, sigurimit, të shfrytëzimit apo koncensionit, të shoqërive aksionere dhe forma të tjera të bashkëpunimit industrial apo tregtar; të ndërtimit të veprave, transportit të mallrave dhe pasagjerëve nga ajri, deti, dhe toka.

2.Rregulla interpretimi:

- a) Në interpretim të këtij ligji, duhet të mbahet në konsideratë karakteri i tij ndërkombëtar dhe nevoja për të nxitur uniformitetin në zbatimin e tij dhe respektimin e parimit të mirëbesimit. Pyetjet në lidhje me çështje që rregullohen nga ky ligj të cilat nuk janë përcaktuar shprehimisht në të, duhet të përcaktohen në përputhje me parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohet ky ligj.
- b) Kur një dispozitë e këtij ligji, përveç nenit 40, parashikon të drejtën e palëve për të vendosur mbi një çështje të caktuar, palët mund të autorizojnë një palë të tretë qoftë kjo dhe një institucion, për ta ushtruar këtë të drejtë.

- c) Kur një dispozitë e këtij ligji i referohet një marrëveshjeje mes palëve, kjo marrëveshje përfshin çdo rregull për zhvillimin e arbitrazhit në rast se palët u referohen këtyre rregullave në marrëveshjen e tyre.
- ç) Dispozitat e këtij ligji që i referohen kërkesëpadi se deklaratës së mbrojtjes zbatohen edhe për kundërpadinë dhe prapësimet ndaj kundërpadisë, me përjashtim të shkronjës “a” të nenit 38 dhe shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 46 të këtij ligji.

Neni 4

Marrëveshja për dhënien e juridiksionit arbitrazhit të huaj

1. Personat fizikë dhe juridikë që kanë selinë e tyre në Republikën e Shqipërisë mund të bien dakord të paraqesin mosmarrëveshjet e tyre në një arbitrazh të huaj, përveç rasteve kur mosmarrëveshja i nënshtrohet juridiksionit ekskluziv të një gjykate të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Njoftimi i komunikimeve me shkrim

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, çdo komunikim me shkrim konsiderohet i dorëzuar në ditën kur është dërguar në adresën postare ose në adresën e postës elektronike të marrësit ose personit të caktuar për të marrë komunikimin me shkrim.

2. Adresa postare është adresa në të cilën marrësi pranon rregullisht postën. Nëse marrësi nuk ka përcaktuar shprehimisht ndonjë adresë tjetër ose nëse rrethanat e çështjes nuk tregojnë ndryshe, adresë postare do të jetë adresa e selisë ose e degës së marrësit, adresa e vendbanimit të tij ose adresa e referuar në kontratë ose në marrëveshjen e arbitrazhit. Rregullat e parashikuara në këtë pikë zbatohen *mutatis mutandis* në lidhje me adresën e postës elektronike.

Për qëllime të këtij ligji, postë elektronike është çdo mesazh në formën e tekstit, tingullit apo imazhit, të dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa marrësi ta marrë atëkomunikim elektronik.

3. Nëse asnjë nga adresat e përmendura në pikën 2, të këtij neni nuk janë të ditura, komunikimi me shkrim do të konsiderohet i dërguar në ditën kur njoftimi i saj është dërguar në adresën e fundit të njohur, me kusht që ajo të jetë dërguar rregullisht me anë të postës rekomande.

4. Një njoftim me shkrim konsiderohet i dërguar, në rast se dërgimi është bërë në përputhje me parashikimet e pikës 2 dhe 3, të këtij neni, edhe nëse marrësi refuzon ta pranojë atë, nuk di ose nuk mund të nënshkruajë, sipas shënimit përkatës në aktin objekt njoftimit.

5. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për njoftimet në proceset gjyqësore të cilat rregullohen nga Kodi i Procedurës Civile.

Neni 6

Heqja dorë nga e drejta për kundërshtim

1. Nëse pala që është në dijeni të shkeljes së një dispozite të këtij ligji apo të mos përmbushjes së një kërkesë të parashikuar në marrëveshjen e arbitrazhit nga pala tjetër dhe, pavarësisht kësaj, vazhdon procesin e arbitrazhit duke mos paraqitur kundërshtim në lidhje me këtë shkelje apo mospërmbushje menjëherë ose brenda afatit të caktuar për paraqitjen e tyre, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e saj për të kundërshtuar.

Neni 7

Përfshirja e gjykatës

1. Asnjë gjykatë nuk ndërhyr në çështjet e rregulluara nga ky ligj, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.,

Neni 8

Funksionet e gjykatës në mbështetje dhe mbikëqyrje nga gjykata

1. Funksionet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 50, të këtij ligji do kryhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Funksionet e parashikuara në pikën 2, të nenit 49, në pikën 3, të nenit 50 dhe në pikën 1, të nenit 52, të këtij ligji do të kryhen nga Gjykata e Apelit Tiranë.

KREU II

MARRËVESHJA E ARBITRAZHIT

Neni 9

Palët dhe objekti i marrëveshjes së arbitrazhit

1. Njëmosmarrëveshje mund të zgjidhet përmes arbitrazhit vetëm nëse ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë që mosmarrëveshja të zgjidhet përmes arbitrazhit.

2. Marrëveshja e arbitrazhit mund të lidhet nga çdo person fizik ose juridik, përfshirë dhe personat juridikë publik. Zotësia e personave fizikë dhe juridikë privat dhe publik për të lidhur një marrëveshje arbitrazhi dhe për të qenë palë në një procedurë arbitrazhi rregullohet nga ligji i zbatueshëm ndaj tyre.

3. Objekt i një marrëveshjeje arbitrazhi mund të jetë çdo padi që përfshin një interes ekonomik. Paditë e tjera mund të jenë objekt i një marrëveshjeje arbitrazhi vetëm në masën që palëve i lejohet t'i zgjidhin ato sipas legjislacionit material dhe procedural në fuqi.

Neni 10

Forma e marrëveshjes së arbitrazhit

1. Marrëveshja e arbitrazhit bëhet me shkrim. Marrëveshja e arbitrazhit mund të jetë në formën e një klauzole të posaçme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh në kontratën e lidhur midis palëve ose në formën e një kontrate të posaçme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh.
2. Marrëveshja e arbitrazhit është me shkrim nëse është pjesë e një akti të nënshkruar nga palët ose në shkëmbimin e letrave, fakseve, telegrameve, postës elektronike apo mjeteve të tjera të komunikimit ose regjistrimit të të dhënave, të cilat mund të dokumentohen dhesigurojnë një provë të marrëveshjes së arbitrazhit.
3. Marrëveshja e arbitrazhit është me shkrim, pavarësisht parashikimeve të pikës 2, të këtij neni edhe nëse përfshihet në një akt të dërguar nga njëra palë tek tjetra ose të dërguar nga një person i tretë tek të dyja palët, dhe nëse nuk është kundërshtuar nga njëri prej tyre brenda një afati kohor të arsyeshëm në përputhje me praktikën e zakonshme tregtare, e cila konsiderohet pjesë e kontratës.
4. Marrëveshja e arbitrazhit është e vlefshme edhe në rast kur kontrata midis palëve bën referim të drejtpërdrejt në një dokument tjetër që përmban klauzolën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh, me kusht që kontrata të jetë nënshkruar në përputhje me pikat 2 dhe 3, të këtij neni.
5. Marrëveshja e arbitrazhit është e vlefshme edhe në rast se pala paditëse fillon procedurën e arbitrazhit dhe i padituri nuk kundërshton juridiksionin e gjykatës së arbitrazhit, jo më vonë se në datën e depozitimit të deklaratës së mbrojtjes.

Neni 11

Paditë përpara gjykatave

1. Gjykata, para së cilës është ngritur një padi lidhur me një çështje, e cila i nënshtrohet arbitrazhit, deklaron mungesën e juridiksionit dhe pushon gjykimin, nëse një palë e kërkon këtë jo më vonë se sa kur dorëzon prapësimet me shkrim mbi themelin e çështjes, , përveç rastit kur gjykata çmonse marrëveshja e arbitrazhit nuk ekziston, është e pavlefshme, apoka pushuar së qeni e vlefshme, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural civil.
2. Gjykata, pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, me kërkesën e palëve në marrëveshjen e arbitrazhit mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përpara ose gjatë procedurës së arbitrazhit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural civil. Kjo dispozitë është e zbatueshme edhe përpara ose gjatë procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar.

KREU III

PËRBËRJA E GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 12
Numri i arbitrave

1. Palët janë të lira të përcaktojnë numrin e arbitrave. Në mungesë të këtij përcaktimi numri i arbitrave duhet të jetë tre.

Neni 13
Emërimi i arbitrit

1. Asnjë person nuk përjashtohet për të vepruar si arbitër, për shkak të shtetësisë së tij, përveç kur palët bien dakord ndryshe.

2. Palët kanë të drejtë të përcaktojnë procedurën e emërimit të arbitrit ose arbitrave, me kushtin që kjo procedurë të jetë në përputhje me parashikimet e pikës 3 dhe 4, të këtij neni. Në rast se palët nuk kanë përcaktuar procedurën e emërimit, arbitrat caktohen sipas procedurës së mëposhtme:

- a) Në një procedurë arbitrazhi me tre arbitra, secila palë emëron një arbitër dhe dy arbitrat e emëruar nga palët emërojnë arbitrin e tretë. Nëse njëra palë nuk e emëron arbitrin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për të emëruar arbitrin, ose nëse dy arbitrat nuk arrijnë të bien dakord për emërimin e arbitrit të tretë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga emërimi i tyre, me kërkesën e palëve arbitri përkatës emërohet nga Gjykata;
- b) Në një arbitrazh me një arbitër të vetëm, nëse palët nuk janë në gjendje të bien dakord mbi arbitrin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i procedurave të arbitrazhit sipas nenit 34, të këtij ligji, me kërkesën e palëve arbitri emërohet nga Gjykata .

3. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, njëra palë mund të kërkojë nga gjykata emërimin e një arbitri, në rastet kur:

- a) Njëra palë nuk kryen veprimet e nevojshme sipas parashikimeve të kësaj procedure emërimi;
- b) palët, ose dy arbitrat, nuk gjejnë dakordësinë sipas kësaj procedure emërimi; ose
- c) një palë e tretë, duke përfshirë një institucion arbitrazhi, nuk përmbush detyrat që i janë ngarkuar sipas kësaj procedure emërimi.

4. Gjykata në emërimin e një arbitri merr në konsideratë kualifikimet profesionale të arbitrit të përcaktuar në marrëveshjen midis palëve ose që janë të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe çdorrethanë tjetër që garanton emërimin e një arbitri të pavarur dhe të paanshëm. Kundër vendimit të Gjykatës në përputhje me parashikimet e pikave 2 dhe 3, të këtij neni nuk lejohet ankimi.

Neni 14
Të drejtat dhe detyrimet e arbitrit

1. Personi, të cilit palët ose Gjykata i propozojnë emërimin e tij si arbitër, është i detyruar të bëjë publike të gjitha rrethanat të cilat mund të shkaktojnë dyshime të arsyeshme mbi paanësinë ose pavarësinë e tij. Arbitri, nga data e emërimit dhe gjatë gjithë procedurës së arbitrazhit, është i detyruar të bëjë publike çdo rrethanë para palëve nëse palët nuk janë njoftuar paraprakisht për këto rrethana.

2. Secila palë mund të kërkojë përjashtimin e cilitdo arbitër, nëse ajo ka dyshime të arsyeshme lidhur me paanësinë ose pavarësinë e arbitrit, ose nëse arbitri nuk i posedon kualifikimet për të cilat palët kanë rënë dakord. Pala mund të kërkojë përjashtimin e arbitrit të cilin e ka emëruar ajo, vetëm nëse arsyet për përjashtimin e tij kanë lindur pas emërimit të arbitrit.

Neni 15

Procedura për kundërshtimin e arbitrit

1. Palët kanë të drejtë të përcaktojnë procedurën e përjashtimit të arbitrit në marrëveshjen e arbitrazhit ose në një marrëveshje të posaçme. Në mungesë të marrëveshjes, secila nga palët mund të kërkojë me shkrim përjashtimin e arbitrit, jo më vonë se 15 ditë nga marrja e dëgjimit për shkakun e përjashtimit ose në rast se gjykata e arbitrazhit është formuar, jo më vonë se 15 ditë nga krijimi i kësaj gjykate, kur pala ka marrë dëgjimin për shkaqet e përjashtimit përpara krijimit të gjykatës së arbitrazhit.

2. Gjykata e Arbitrazhit, përfshirë arbitrin e kundërshtuar, vendos për përjashtimin e arbitrit, përveç rasteve kur arbitri që kërkon të kundërshtohet heq dorë nga detyra e ngarkuar ose pala tjetër pranon përjashtimin.

3. Pala, në rast mospranimi të kërkesës për kundërshtimin e arbitrit sipas pikës 2, të këtij neni, ka të drejtë të bëjë ankim pranë Gjykatës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e dëgjimit të vendimit të grupit gjyqësor të arbitrave. Shqyrtimi i ankimit nga gjykata nuk pezullon procedurat e arbitrazhit. Kundër vendimit të Gjykatës nuk lejohet ankim.

Neni 16

Paaftësia ose pamundësia për të ushtruar detyrën

1. Detyra e një arbitri që bëhet *de jure* ose *de facto* i paaftë për të përmbushur funksionet e tij, përfundon kur ai tërhiqet nga kjo detyrë, ose kur palët bien dakord përfundimisht e kësaj detyre. Në rast se ka kundërshtime në lidhje me pamundësinë e përmbushjes së detyrave të arbitrit, pala mund t'i kërkojë Gjykatës të vendosë mbi përfundimin e mandatit të arbitrit. Kundër vendimit të Gjykatës nuk lejohet ankim.

2. , , Heq dorë e arbitrit nga detyra ose vendosja e përfundimit të detyrës së arbitrit nga palët, nuk nënkupton pranimin e vlefshmërisë së shkaqeve të parashikuara në pikën 1, të këtij neni ose në pikën 1, të nenit 15 të këtij ligji.

Neni 17

Emërimi i arbitrit zëvendësues

1. Kur mandati i një arbitri përfundon në përputhje me këtë ligj, arbitri zëvendësues emërohet në përputhje me rregullate zbatueshme për emërimin e arbitrit që zëvendësohet.

KREU IV

JURISDIKSIONI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 18

Kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të vendosur mbi juridiksionin e saj

1. Gjykata e arbitrazhit mund të marrë në shqyrtim dhe të vendosë nëse çështja objekt gjykimi është në juridiksionin e saj si dhe për çdo pretendim për pavlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit. Klauzola e marrëveshjes së arbitrazhit, kur është pjesë e një kontrate, trajtohet si një marrëveshje e posaçme dhe e pavarur nga kushtet e tjera të kontratës. Vendim i gjykatës së arbitrazhit që deklaron pavlefshmërinë e kontratës nuk passjell *ipso jure* pavlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.

2. Pretendimet për mungesën e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit paraqiten nga palët jo më vonë se në datën e dorëzimit të deklaratës së mbrojtjes. Palët kanë të drejtë të paraqesin këtë pretendim edhe nëse kanë emëruar, ose kanë marrë pjesë në emërimin e një arbitri.

3. Gjykata e arbitrazhit mund të vendosë mbi kërkesat ose pretendimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, me vendim të ndërmjetëm ose me vendim përfundimtar. Nëse gjykata e arbitrazhit vendos me vendim të ndërmjetëm se ka juridiksion për të shqyrtuar mosmarrëveshjen, çdo palë mund t'i kërkojë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për këtë vendim, gjykatë të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji, të vendosë mbi çështjet e mungesës së juridiksionit.

4. . Shqyrtimi i kërkesës nga gjykata nuk pezullon vazhdimin e procedurave të arbitrazhit dhe marrjen e vendimit..

Neni 19

Marrja e masave të përkohshme

1. Gjykata e arbitrazhit, nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga palët, në çdo kohë para dhënies së vendimit përfundimtar, me kërkesë të një pale mund të japë kundër palës tjetër një masë të përkohshme që e çmon të përshtatshme bazuar në kriteret si vijon:

- a) pala kërkuese mund të pësojë dëme të rëndësishme për të drejtat e saj nga vonesa e ekzekutimit, të cilat nuk mund të vihen në vend;
- b) ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur, ose do të vështirësohet së tepërmi;

c) ekziston mundësia e arsyeshme që pala kërkuese të ketë sukses për themelin e padisë. Ky vendim nuk cenon zgjedhjen e gjykatës së arbitrazhit në marrjen e çdo vendimi të mëvonshëm.

2. Gjykata e arbitrazhit jep masën e parashikuar në pikën 1, të këtij neni pasi ka marrë në konsideratë objektin e mosmarrëveshjes dhe pasi i jep palës tjetër mundësinë për të paraqitur prapësimet e saj në lidhje me kërkesën. Gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë nga çdo palë që të japë garancitë e përshtatshme në lidhje me masën.

3. Gjykata e arbitrazhit mund të ndryshojë, pezullojë ose pushojë masën e përkohshme që ka dhënë, me kërkesën e një pale ose, në rrethana të jashtëzakonshme dhe me njoftim paraprak të palëve, me nismën e vetë gjykatës së arbitrazhit.

4. Nëse pala nuk zbaton vendimin e gjykatës së arbitrazhit për masën e përkohshme zbatohen parashikimet e nenit 52 të këtij ligji.

Neni 20

Ekzekutimi i masave të përkohshme

1. Njohja e një mase të përkohshme të dhënë nga një gjykatë e arbitrazhit vendoset nga Gjykata në përputhje me rregullat dhe parashikimet e legjislacionit procedural civil që rregullojnë sigurimin e padive.

2. Gjykata refuzon kërkesën për ekzekutimin e masës së përkohshme për shkaqet e përmendura në pikën 2 dhe 3 të nenit 49 të këtij ligji, si dhe kur pala kundër të cilës kërkohet ekzekutimi provon se gjykata e arbitrazhit e ka ndryshuar, pezulluar ose ndërprerë masën e përkohshme përpara paraqitjes së kërkesës për ekzekutimin e masës së përkohshme.

3. Pala që kërkon ose që ka marrë urdhrin për ekzekutimin e një mase të përkohshme të dhënë nga gjykata e arbitrazhit njofton menjëherë gjykatën që ka dhënë urdhrin për çdo ndryshim, pezullim ose ndërprerje të masës së përkohshme.

4. Gjykata në bazë të kërkesës së një pale mund të ndërpresë ose ndryshojë urdhrin e saj për ekzekutimin e masës së përkohshme.

Neni 21

Kushtet për dhënien e masave të përkohshme

1. Pala që kërkon marrjen e një mase të përkohshme sipas parashikimeve të bëra në germet “a”, “b” dhe “c” të pikës 2, të nenit 18, e bind gjykatën e arbitrazhit që:

(a) Dëmi nuk mund të riparohet siç duhet me një vendim dëmshpërblimi nëse masa nuk është urdhëruar, dhe një dëm i tillë kryesisht e tejkalon dëmin që mund t'i rezultojë palës kundër të cilës drejtohet masa nëse masa është dhënë; dhe

- (b) Ka një mundësi të arsyeshme që pala kërkuese e kësaj mase sigurimi do të ketë sukses për themelin e padisë. Vendimi mbi këtë mundësi nuk cënon zgjedhjen e gjykatës së arbitrazhit në marrjen e çdo vendimi të mëvonshëm.
2. Në lidhje me një kërkesë për masë të përkohshme sipas germës “d” të pikës 2 të nenit 18, dhe germave “a” dhe “b” të pikësl, të këtij neni zbatohen vetëm në masën që gjykata e arbitrazhit i konsideron të përshtatshme.

Neni 22

Kërkesat për lëshimin e urdhrave paraprakë dhe kushtet për pranimin e tyre

1. Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga palët, secila prej palëve, pa njoftuar palën tjetër, mund të bëjë një kërkesë për marrjen e masës së përkohshme anë të së cilës të të kërkojë që pala tjetër të mos pengojë zbatimin e masës së sigurimit të padisë të kërkuar.
2. Gjykata e arbitrazhit mund të lëshojë një urdhër paraprak, nëse çmon se njoftimi paraprak i kërkesës për masën paraprake ndaj palës kundër të cilës drejtohet, rrezikon të pengojë qëllimin e masës.
3. Kushtet e përcaktuara sipas nenit 18 zbatohen për çdo urdhër të ndërmjetëm, në rast se dëmi që do të vlerësohet sipas germës “a” të pikës 1, të nenit 19, është dëmi që mund të rezultojë nga marrja ose jo e urdhrat paraprak.

Neni 23

Regjimi specifik për urdhërat paraprak

1. Pasi gjykata e arbitrazhit të ketë marrë një vendim në lidhje me një kërkesë për një urdhër paraprak, do të njoftojë palët në lidhje me kërkesën për masën e përkohshme, kërkesën për urdhërin e përkohshëm, nëse ka të tillë, dhe të gjitha komunikimet e tjera, duke përfshirë regjistrimin e përmbajtjes së ndonjë komunikimi verbal ndërmjet palëve dhe gjykatës së arbitrazhit.
2. Njëkohësisht, gjykata e arbitrazhit i jep mundësi çdo pale kundër të cilës drejtohet një urdhër i përkohshëm, të paraqesë çështjen e saj sa më shpejt që të jetë e mundur.
3. Gjykata e arbitrazhit do të vendosë menjëherë për çdo kundërshtim ndaj vendimit të ndërmjetëm.
4. Vlefshmëria e urdhrat të përkohshëm përfundon pas 20 (njëzet) ditësh nga data e lëshimit të tij prej gjykatës së arbitrazhit. Megjithatë, gjykata e arbitrazhit mund të lëshojë një masë të përkohshme që miraton ose ndryshon, vendimin e ndërmjetëm, pasi pala kundër të cilës drejtohet urdhri paraprak, të ketë dhënë njoftim dhe të ketë mundësi për të paraqitur kërkesë padinë e saj.
5. Urdhri i përkohshëm do të jetë detyrues për palët por nuk do t'i nënshtrohet zbatimit nga

një gjykatë. Ky urdhër paraprak nuk përbën një vendim.

Neni 24

Ndryshimi, pezullimi, përfundimi

1. Gjykata e arbitrazhit mund të ndryshojë, pezullojë ose përfundojë një masë paraprake ose një urdhër të përkohshëm që ka lëshuar, mbi bazën e kërkesës së palës së interesuar dhe në raste të jashtëzakonshme dhe me iniciativën e vet, pasi të ketë njoftuar paraprakisht palët për nisjen e kësaj procedure.

Neni 25

Garancia

1. Gjykata e arbitrazhit mund t'i kërkojë palës që kërkon marrjen e një mase të përkohshme të ofrojë garancinë e përshtatshme në lidhje me kërkesën e bërë.

2. Gjykata e arbitrazhit nëse e çmon të përshtatshme ose të nevojshme i kërkon dhënien e garancisë dhe palës që kërkon lëshimin e një urdhri procedural për sigurimin e padisë në lidhje me masën e natyrën e urdhrit të përkohshëm, me përjashtim të rastit kur kjo gjykatë e konsideron të panevojshme apo të papërshtatshme dhënien e kësaj garancie për shkaqe që lidhen me natyrën e urdhrit.

Neni 26

Detyrimi për paraqitjen e rrethanave dhe fakteve të mosmarrëveshjes

1. Gjykata e arbitrazhit mund t'i kërkojë çdo pale që të njoftojë menjëherë palën tjetër, në lidhje me çdo ndryshim material të rrethanave mbi bazën e të cilit është kërkuar apo lëshuar urdhri i përkohshëm.

2. Pala që kërkon lëshimin e një urdhri të përkohshëm njofton gjykatën e arbitrazhit për të gjitha rrethanat që mund të ndikojnë në marrjen e vendimit nga gjykata e arbitrazhit në lidhje me lëshimin e masës ose urdhrit. Ky detyrim do të jetë në fuqi derisa pala kundër të cilës është kërkuar urdhri, të ketë mundësi për të paraqitur prapësimet dhe qëndrimin e saj për mosmarrëveshjen. Parashikimi i paragrafit të parë të këtij neni do të vazhdojë të jetë në fuqi edhe pas këtij momenti.

Neni 27

Kostot dhe dëmet

1. Pala që kërkon lëshimin e urdhrit për marrjen e një mase sigurimi të padisë ose një urdhri paraprak, është përgjegjëse për kostot dhe dëmet e shkaktuara për çdo palë nga masa e sigurimit ose urdhri paraprak procedural, nëse gjykata e arbitrazhit më pas vendos se masa ose vendimi nuk duhet të ishin lëshuar në këto rrethana. Gjykata mund të shprehet në lidhje me përgjegjësinë për pagesën e shpenzimeve dhe dëmit në çdo fazë të gjykimit të arbitrazhit.

Neni 28
Njohja dhe zbatimi

1. Një masë e përkohshme për sigurimin e padisë e lëshuar nga një gjykatë arbitrazhi njihet si detyruese dhe nëse nuk urdhërohet ndryshe nga gjykata e arbitrazhit, zbatohet pas kërkesës për gjykatën kompetente, pavarësisht nga vendi në të cilin është lëshuar, në bazë të dispozitave të nenit 29.
2. Pala që kërkon ose ka siguruar njohjen ose zbatimin e një mase të përkohshme, do të informojë menjëherë gjykatën për çdo përfundim, pezullim ose ndryshim të asaj mase.
3. Gjykata e Shtetit ku kërkohet njohja ose zbatimi, nëse e çmon të nevojshme, mund të urdhërojë palën kërkuese të ofrojë garancinë e duhur, nëse gjykata e arbitrazhit nuk ka marrë një vendim në lidhje me garancinë ose kur ky vendim është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta.

Neni 29
Arsyet për refuzimin e njohjes ose zbatimit

1. Njohja ose zbatimi i një mase të sigurimit të padisë mund të refuzohet:
 - a) Me kërkesë të palës kundër të cilës drejtohet, nëse gjykata bindet se:
 - i. Ky refuzim kërkohet në bazë të arsyeve të përcaktuara në pikën 1, germa “a”, nënparagrafët “i”, “ii”, “iii” ose “iv” të nenit 53; ose
 - ii. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit në lidhje me ofrimin e garancisë mbi masën e sigurimit të padisë të lëshuar nga gjykata e arbitrazhit, nuk është respektuar; ose
 - iii. Masa e sigurimit të padisë është përfunduar ose pezulluar nga gjykata e arbitrazhit, kur autorizohet për këtë nga gjykata e Shtetit në të cilin zhvillohet arbitrazhi, sipas ligjit të të cilit është lëshuar kjo masë; ose
 - b) Nëse gjykata konstaton se:
 - i. Masa e sigurimit të padisë është e papajtueshme me kompetencat e dhëna gjykatës së arbitrazhit dhe gjykata nuk vendos të riformulojë masën e sigurimit, në masën e nevojshme, për t’u përshtatur atë me kompetencat dhe procedurat e veta, për qëllimet e zbatimit të asaj mase dhe pa ndryshuar thelbin e saj; ose
 - ii. Secila prej arsyeve të përcaktuara në nenin 53 paragrafi i parë pika 1, germa “b” nën paragrafët “i” ose “ii”, zbatohet për njohjen dhe zbatimin e masës së sigurimit të padisë.
2. Çdo vendim i marrë nga gjykata në bazë të ndonjë prej arsyeve të parashikuara në paragrafin parë të këtij neni, do të hyjë në fuqi vetëm për qëllimet e zbatimit për njohjen dhe zbatimin e masës së sigurimit të padisë. Në marrjen e një vendimi, gjykata ku kërkohet njohja ose zbatimi, nuk do të kryejë një rishikim të themelit të masës së sigurimit.

Neni 30

Masat e sigurimit të padisë të lëshuara nga gjykata

1. Gjykatat kanë të drejtë të marrin masa për sigurimin e padisë në lidhje me çështje që shqyrtohen në arbitrazh, edhe nëse vendi i zhvillimit të procedurave të arbitrazhit nuk është Republika e Shqipërisë, me kusht që të jenë kompetente për shqyrtimin e tyre sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata duhet ta përdorë këtë të drejtë në përputhje me karakterin e posaçëm të arbitrazhit ndërkombëtar.

KREU V ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË ARBITRAZHIT

Neni 31

Trajtimi i barabartë i palëve

1. Palët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe secilës palë i jepet mundësia e plotë për të paraqitur mjetet, shpjegimet, faktet, dokumentet dhe provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në gjykim.

Neni 32

Përcaktimi i rregullave procedural

1. Palët janë të lira të bien dakord mbiprocedurën që do të ndiqet nga gjykata e arbitrazhit në zhvillimin e procesit të gjykimit, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

2. Në rast se palët nuk kanë përcaktuar rregullat procedurale sipas përcaktimit të paragrafit të mësipërm, gjykata e arbitrazhit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë të caktojë rregullat procedurale që vlerësojnë përshtatshme. E drejta e gjykatës së arbitrazhit për të përcaktuar rregullat procedurale përfshin edhe të drejtën për të përcaktuar mënyrën e marrjes së provave dhe fuqinë provuese të tyre.

Neni 33

Vendi i arbitrazhit

1. Palët kanë të drejtë të caktojnë vendin se ku do të zhvillohet procedura e arbitrazhit. Në rast se palët nuk e kanë caktuar, vendi i arbitrazhit përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit duke pasur në konsideratë rrethanat e çështjes, përfshirë edhe lehtësirat për palët.

2. Gjykata e arbitrazhit, pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të këtij neni apo nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, mund të mbliidhet në çdo vend që eçmon të përshtatshëm për:

- a) konsultiminndërmjet arbitrave;
- b) dëgjimine dëshmitarëve, ekspertëve ose palëve; ose
- c) këqyrjesendeve, të luajtshme ose të paluajtshme ose çdo dokumenti tjetër.

Neni 34

Fillimi i procedurës së arbitrazhit

1. Nëse në marrëveshjen e lidhur midis palëve nuk parashikohet ndryshe, gjykimi i një mosmarrëveshje me arbitrazh fillon në datën në të cilën i njoftohet palës tjetër kërkesa për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje me arbitrazh.

Neni 35

Gjuha

1. Palët janë të lira të bien dakordpër gjuhën ose gjuhët që do të përdoren gjatë procedurës së arbitrazhit. Në rast se palët nuk e kanë caktuar, gjuha ose gjuhët që përdoren nga gjatë procedurës së arbitrazhit përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit. Marrëveshja ose vendimi për caktimin e gjuhës, nëse nuk përcaktohet ndryshe, zbatohet dhe për çdo shpjegim dhe pretendimi me shkrim të paraqitur nga palët, për çdo seancë dëgjimore, si dhe për çdo vendim ose njoftim tjetër të kryer nga gjykata e arbitrazhit.

2. Gjukata e arbitrazhit mund të urdhërojë që çdo provë me shkresë të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën ose gjuhët e caktuara me marrëveshje midis palëve ose të përcaktuara nga gjykata e arbitrazhit.

3. Kërkesëpadia dhe parashtrimet e tjera mund të bëhen në gjuhën e kontratës që përmban klauzolën e arbitrazhit, të marrëveshjes së arbitrazhit ose në gjuhën shqipe deri në momentin e përcaktimit të gjuhës së përdorur gjatë procedurës së arbitrazhit, përveç kur është rënë dakord ndryshe nga palët.

Neni 36

Kërkesëpadia dhe deklarataembrojtjes

1. Kërkesëpadia paraqitet nga paditësi brenda afatit të caktuar me marrëveshjen nga palët ose të përcaktuar nga gjykata e arbitrazhit. Kërkesëpadia duhet të përmbajë:

- a) të dhënat elektronike dhe postare të kontaktit të palës paditësedhe të paditur dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë;
- b) objektin e padisë;
- c) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të së drejtës mbi të cilat mbështetet padia, si dhe kërkimin konkret të palës paditëse;

- c) listën e personave që kërkon të thirren në cilësinë e dëshmitarit, duke saktësuar emrin, atësinë, mbiemrin dhe adresën e plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;
- d) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;
- dh) çdo akt tjetër qëpala paditëse e çmon të vlefshëm për të mbështetur parashtrimet e saj.

2. Deklarata e mbrojtjes paraqitet nga i padituri brenda afatit të caktuar me marrëveshjen e palët ose të përcaktuar nga gjykata e arbitrazhit. Deklarata e mbrojtjes duhet të përmbajë:

- a) të dhënat elektronike dhe postare të kontaktit të palës paditëse dhe të paditur dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë;
- b) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e padisë, nëse ka;
- c) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitaritsi dhe faktet që kërkohet të provohen me to;
- ç) provat që kërkohen të merren tek të tretët ose te pala paditëse;
- d) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;
- dh) kundërpadinë, nëse ka;
- e) çdo akt tjetër që pala e paditur e çmon të vlefshëm për të mbështetur prapësimet e saj.

Neni 37

Seancat dhe procedurat me shkrim

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit mund vendosë nëse do të mbahet seanca dëgjimore apo nëse procedura do të zhvillohet vetëm në bazë të dokumenteve dhe materialeve të tjera të shkruara. Gjukata e arbitrazhit vendos të zhvillojë një seancë dëgjimore kur, duke pasur në konsideratë rrethanat e çështjes, vlerësohet si të arsyeshme ose mbi bazën e kërkesës së njëres prej palëve.

2. Palët duhet të informohen paraprakisht dhe në një kohë të arsyeshme në lidhje me çdo seancë dëgjimore dhe çdo mbledhje të gjykatës së arbitrazhit e cila ka për qëllim marrjen e provave.

3. Të gjitha deklaratat, kërkesat, aktet ose informacionet e tjera të cilat njëra palë i dorëzon gjykatës së arbitrazhit i komunikohen palës tjetër. Gjithashtu, palëve i komunikohet çdo raport eksperti ose dokument provues në të cilin gjykata e arbitrazhit mund të mbështetet në marrjen e vendimit të saj.

Neni 38

Gjykimi në mungesë

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe dhe në mungesë të një shkakut të arsyeshëm:

- a) në rast se paditësi nuk e paraqet kërkesëpadinë në përputhje me pikën 1, të nenit 36, gjykata e arbitrazhit përfundon procedurën e arbitrazhit dhe pushon gjykimin ;

- b) në rast se i padituri nuk paraqet deklaratën e mbrojtjes në përputhje me pikën 2, të nenit 36, gjykata e arbitrazhit vazhdon procedurat duke mos e vlerësuar këtë pamundësi të të paditurit si pranim nga ana e tij të pretendimeve të paditësit;
- c) nëse një palë nuk paraqitet në seancë ose nuk paraqet prova shkresore, gjykata e arbitrazhit mund të vazhdojë procesin e gjykimit dhe të marrë vendimin mbi provat e paraqitura deri në atë moment prej saj.

Neni 39

Dëshmitarët

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, dëshmitarët si rregull thirren për të dëshmuar gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore..
2. Dëshmitarët, me pëlqimin e palëve, mund të pyeten nga gjykata e arbitrazhit jashtë seance dëgjimore ose mund të kërkohen që t'i përgjigjen me shkrim pyetjeve të gjykatës së arbitrazhit brenda një periudhe të caktuar kohore.
3. Dëshmitarët dëgjohen dhe pyeten nga gjykata e arbitrazhit duke zbatuar për atë që është e zbatueshme parashikimet e legjislacionit procedural civil për pyetjen e dëshmitarëve.

Neni 40

Ekspertët

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit:
 - a) mund të caktojë një ose më shumë ekspertë për t'i raportuar asaj mbi çështje specifike që do të përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit;
 - b) mund t'i kërkojë një palë t'i japë ekspertit çdo informacion të lidhur me çështjen, ose të përgatisë apo garantojë akses në dokumente, mallra ose pasuri të tjeratë lidhura me çështjen për inspektim nga ana e tij.
2. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, eksperti, t, pas paraqitjes së raportit të tij me shkrim ose me gojë, mbi bazën e kërkesës së një palë ose nëse gjykata e arbitrazhit e çmon të nevojshme, merr pjesë në seancë, ku palët kanë mundësi t'i bëjnë pyetje dhe të paraqesin dëshmitarë ekspert mbi fushën për të dëshmuar mbi çështjet në konkrete.

Neni 41

Ndihma e gjykatës në marrjen e provave

1. Gjkata e arbitrazhit ose një palë me miratimin e gjykatës së arbitrazhit, mund të kërkojnë ndihmë nga një gjykatë kompetente në marrjen ose sigurimin e provave. Gjkata mund të ekzekutojë kërkesën brenda kompetencës për marrjen e provave, sipas rregullave dhe parashikimeve të legjislacionit procedural civil.

KREU VI

MARRJA E VENDIMIT DHE PËRFUNDIMI I PROCEDURAVE,

Neni 42

Rregullat e zbatueshme për thelbin e mosmarrëveshjes

1. Gjykata e arbitrazhit vendos mbi mosmarrëveshjen në përputhje me parashikimet e ligjittë zgjedhur nga palët si të zbatueshëm për thelbin e mosmarrëveshjes. Çdo përcaktim i ligjit ose sistemit ligjor të një shteti të caktuar, përveç kur është rënë shprehimisht dakord ndryshe nga palët, interpretohet se i referohet drejtpërdrejt ligjit material të atij shteti dhe jo rregullimit të tij ligjor për të drejtën ndërkombëtare private.
2. Gjykata e arbitrazhit, në mungesë të përcaktimit nga palët sipas pikës 1 të këtij neni, zbaton parashikimet e ligjit shqiptar. Gjykata e arbitrazhit gjatë zhvillimit të procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar zbaton parashikimet e ligjit që çmon se është i zbatueshëm në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për të drejtën ndërkombëtare private.
3. Gjykata e arbitrazhit mund të vendosë sipas parimit *ex aequo et bono* ose *amiable compositeur* vetëm nëse palët e kanë lejuar këtë gjë shprehimisht.
4. Gjykata e arbitrazhit, në të gjitha rastet, vendos në përputhje me kushtet e kontratës dhe merr në konsideratë zakonet e tregtisë të zbatueshme për transaksionin.

Neni 43

Marrja e vendimit nga trupi i arbitrave

1. Në procedurat e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, çdo vendim i gjykatës së arbitrazhit merret me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, përveç kur është rënë dakord ndryshe nga palët. Megjithatë, çështjet e procedurës mund të vendosen nga një arbitër kryesues, nëse kjo autorizohet nga palët ose të gjithë anëtarët e gjykatës së arbitrazhit.

Neni 44

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim

1. Nëse, gjatë procedurës së arbitrazhit, palët zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim ose me ndërmjetësim, gjykata e arbitrazhit do të përfundojë procesin dhe, nëse kërkohet nga palët dhe nuk kundërshtohet nga gjykata e arbitrazhit, do të regjistrojë marrëveshjen në formën e një vendimi arbitrazhi në bazë të kushteve të rena dakord nga palët.
2. Marrëveshja e palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mirëkuptim ose me ndërmjetësim, me kërkesë të palëve, mund të regjistrohet dhe të shpallet nga gjykata e arbitrazhit në formën e një vendimi arbitrazhi, me përjashtim të rastit kur përmbajtja e marrëveshjes është në kundërshtim me ligjin. Vendimi i arbitrazhit merret në përputhje me dispozitat e nenit 45 dhe

shpallet si vendim i gjykatës së arbitrazhit. Ky vendim ka efekt të njëjtë me çdo vendim tjetër të marrë mbi themelin e çështjes.

Neni 45

Forma dhe përmbajtja e vendimit

1. Vendimi hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga arbitri ose arbitrat, sipas rastit. Në procedurat e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, nënshkrimet e shumicës së të gjithë anëtarëve të gjykatës së arbitrazhit janë të mjaftueshme, me kusht që të deklarohet arsyeja për çdo nënshkrim që mungon.
2. Vendimi përfundimtar i arbitrazhit duhet të jetë i arsyetuar, me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe, ose vendimi është marrë në përputhje me parashikimet e nenit 44 të këtij ligj.
3. Vendimi i arbitrazhit duhet të ketë të përcaktuar datën dhe vendin e arbitrazhit sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Nëse vendi i arbitrazhit nuk është përcaktuar gjatë procedurës së arbitrazhit, vendi i marrjes së vendimit do të konsiderohet si vendi kryerjes së arbitrazhit.
4. Pas marrjes së vendimit, një kopje e nënshkruar nga arbitrat, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, i dorëzohet secilës palë.

Neni 46

Përfundimi i procedurave të arbitrazhit

1. Procedurat e arbitrazhit përfundojnë me marrjen e një vendimi përfundimtar ose një urdhërtë gjykatës së arbitrazhit për mbylljen e procedurës së arbitrazhit në përputhje me pikën 2, të këtij neni.
2. Gjykata e arbitrazhit lëshon urdhër për mbylljen e procedurave të arbitrazhit, kur:
 - a) pala paditëse tërheq padinë, me përjashtim të rastit kur pala e paditur bën kundërshtim dhe gjykata e arbitrazhit çmon se ka një interes të ligjshëm të tij për zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes;
 - b) palët bien dakord për përfundimin e procedurave;
 - c) gjykata e arbitrazhit çmon se vazhdimi i procedurave, për arsye të tjera, është bërë i panevojshëm ose i pamundur.
3. Mandati i gjykatës së arbitrazhit mbaron me përfundimin e procedurave të arbitrazhit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 47 dhe 49, të këtij ligji.

Neni 47

Korrigjimi i gabimeve materiale, interpretimi i vendimit, dhe vendimi shtesë i arbitrazhit

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit të arbitrazhit, nëse palët nuk kanë rënë dakord për një afat tjetër kohor:

- a) Një palë duke njoftuar palën tjetër, mund ti kërkojë gjykatës së arbitrazhit të korrigjojë në vendim gabimet ortografike ose tipografike, gabimet në llogaritje ose çdo gabim tjetër të një natyre të ngjashme;
- b) Nëse palët nuk kanë rënë dakord, një palë, duke njoftuar palën tjetër, mund t'i kërkojë gjykatës së arbitrazhit të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë.

2. Nëse gjykata e arbitrazhit çmon se kërkesa është e bazuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës ajo bën korrigjimin apo interpretimin e vendimit, dhe jep vendim, i cili i bashkohet vendimit përfundimtar të arbitrazhit.

3. Gjukata e arbitrazhit me iniciativën e vetëmund të korrigjojë çdo gabim të natyrës së parashikuar në germën "a", të pikës 1, të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

4. Nëse nga palët nuk është rënë dakord ndryshe, një palë, pas njoftimit të palës tjetër, mund të kërkojë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit, mund të kërkojë vendim shtesë, në rast se gjykata e arbitrazhit nuk është shprehur mbi të gjitha pretendimet e paraqitura në procesin e arbitrazhit. Nëse gjykata e arbitrazhit e vlerëson kërkesën të bazuar, ajo jep vendim shtesë brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

5. Gjukata e arbitrazhit mund të shtyjë, nëse është e nevojshme, periudhën kohore brenda të cilës do të bëjë korrigjimin, interpretimin ose plotësimin e vendimit sipas pikës 1 ose 4 të këtij neni.

6. Parashikimet e nenit 45 zbatohen për korrigjimin ose interpretimin e vendimit të arbitrazhit si dhe për dhënien e vendimit shtesë.

Neni 48

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës së arbitrazhit

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit cakton shpenzimet në vendimin përfundimtar. Në shpenzime përfshihen:

- a) tarifa e gjykatës së arbitrazhit;
- b) shpenzimet dhe shpërblimet e arbitrit/arbitrave ;
- c) shpenzimet për ekspertët dhe ndihmën tjetër të cilën e ka kërkuar gjykata e arbitrazhit dhe për të cilën janë pajtuar palët;
- ç) shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të dëshmitarëve, deri në masën e miratuar nga gjykata e arbitrazhit;
- d) shpenzimet për përfaqësimin dhe ndihmën për palën e suksesshme, nëse kompensimi i këtyre shpenzimeve është kërkuar gjatë procedurës së arbitrazhit, dhe vetëm deri në atë masë që gjykata e arbitrazhit e cakton të arsyeshëm; dhe

dh) të gjitha taksat dhe shpenzimet e gjykatës së arbitrazhit kur kjo bënë emërimin e arbitërve.

2. Shpenzimet e gjykatës së arbitrazhit duhet të jenë të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën e çështjes, kompleksitetin e lëndës, kohën e shpenzuar nga arbitrat dhe rrethanat e tjera të rastit. Në rast se shfaqen mosmarrëveshje në lidhje me shumën e shpenzimeve që duhet paguar gjykatës së arbitrazhit, është gjykata që të vendosë mbi këtë çështje.

3. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, shpenzimet e arbitrazhit i ngarkohen palës humbëse. Gjykata e arbitrazhit mund të ndajë shpenzimet e parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni ndërmjet palëve, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe rezultatit e procedurës së arbitrazhit.

Neni 49

Ankimi kundërvendimit të arbitrazhit

1. Ankimi në gjykatën kundër një vendimi arbitrazhi mund të bëhet vetëm me anë të paraqitjes së një kërkesë për prishjen e vendimit në përputhje me pikat 2, dhe 3 të këtij neni. Palët nuk mund të bien dakord për përjashtim nga edrejta e ankimit.

2. Një vendim arbitrazhi mund të priset nga Gjykata e Apelit e Tiranës bazuar në kërkesën e një pale, dhe provon se:

- a) njëra nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit, të parashikuar në nenin 10, të këtij ligji, nuk kishte zotësi për të lidhur këtë marrëveshje; ose
- b) marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas ligjit të përzgjedhur nga palët ose të ligjit të zbatueshëm për thelbin e mosmarrëveshjes sipas nenit 42, të këtij ligji; ose
- c) nuk është njoftuar në mënyrën e duhur për emërimin e një arbitri ose për fillimin e procedurës së arbitrazhit apo kur për ndonjë shkak tjetër nuk i ishte dhënë mundësi për të paraqitur pretendimet e saj në lidhje me mosmarrëveshjen; ose
- ç) vendimi trajton një mosmarrëveshje që nuk parashikohet ose nuk përfshihet në termat e marrëveshjes për t'iu nënshtruar arbitrazhit, ose
- d) vendimi përmban vendime mbi çështje jashtë objektit të referimit në arbitrazh, me kusht që vendimet mbi çështjet e referuara në arbitrazh mund të ndahen nga vendimet mbi çështje që nuk referohen në arbitrazh dhe në këto raste vetëm ajo pjesë e vendimit që përmban vendime mbi çështjet që nuk referohen në arbitrazh, mund të priset; ose; ose
- dh) përbërja e gjykatës së arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në përputhje me dakordësinë e palëve, përveç rasteve kur kjo dakordësi bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji nga të cilat palët nuk mund të derogojnë, ose, në mungesë të kësaj dakordësie, nuk ka qenë në përputhje me këtë ligj.

3. Gjykata mund të prishë vendimin e arbitrazhit edhe kryesisht nëse vëren se:

- a) çështja objekt i mosmarrëveshjes nuk mund të jetë objekt i gjykimit ndërmjet arbitrazhit sipas nenit 9 të këtij ligji; ose

b) vendimi është nëkundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar.

4. Kërkesa për prishjen e vendimit të arbitrazhit nuk mund të bëhet pas kalimit të njëafati 3 (tre) mujor nga data kur palës që ka bërë kërkesën i është dhënë vendimi ose, nëse kur është paraqitur një kërkesë sipas nenit 47, të këtij ligji, nga data e paraqitjes së kësaj kërkesë para gjykatës së arbitrazhit..

5. Në raste kur kërkohet prishja e vendimit nga njëra prej palëve, gjykata mund të pezullojë procesin gjyqësor për një periudhë kohore të përcaktuar me qëllim që t'i japë gjykatës së arbitrazhit mundësi për të rifilluar procesin e arbitrazhit ose për të marrë masa të tjera të tilla të nevojshme që sipas gjykimit të gjykatës së arbitrazhit, do të eliminojnë shkaqet për shfuqizim.

KREU VII NJOHJA DHE ZBATIMI VENDIMEVE TË GJYKATËSSË ARBITRAZHIT

Neni 50

Juridiksioni gjyqësor dhe procedura

1. Gjkata e shkallës së parë së juridiksionit të zakonshëm të rrethit gjyqësor Tiranë, Seksioni Tregtar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji ka kompetencë të vendosë mbi:
 - a) mungesën e juridiksionit dhe sigurimin e padisë në përputhje me nenin 11;
 - b) emërimin e një arbitri në përputhje me pikën 2, 3 dhe 4 të nenit 13;
 - c) kundërshtimin e një arbitri në përputhje me pikën 3, të nenit 15;
 - ç) ndërprerjen e mandatit të një arbitri në përputhje me pikën 1, të nenit 16;
 - d) juridiksionin e gjykatës së arbitrazhit në përputhje me pikën 3 të nenit 18;
 - dh) urdhrin e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit në përputhje me nenin 51 të këtij ligji.
2. Gjykatamerr vendimet e saj në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin procedural civil.
3. Ankesa kundër një vendimi të Gjykatës shqyrtohet nga Gjykata e Apelit e juridiksionit të zakonshëm me seli në Tiranë sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 51

Ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit vendas

1. Vendimi i arbitrazhit i dhënë nga një gjykatë arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nëse është rezultat i një procedure arbitrazhi të brendshëm ose arbitrazhi ndërkombëtar, vëhet në ekzekutim kur Gjykata lëshon urdhrin e ekzekutimit në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural civil.

2. Gjykata refuzon kërkesën për dhënien e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit të dhënë nga një gjykatë arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë, nëse ekziston një nga shkaqet për prishjen e këtij vendimi, të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 49 të këtij ligji, përveç rastit kur kërkesa për prishjen e vendimit sipas nenit 49 është refuzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë përpara paraqitjes së kërkesës për dhënien e urdhrit të ekzekutimit.

Neni 52

Vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar

1. Vendimi i arbitrazhit i dhënë nga një gjykatë arbitrazhi të një shteti të huaj ose nga një gjykatë e arbitrazhit ndërkombëtar me vendndodhje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vihet në ekzekutim në momentin kur njihet me vendim të Gjykatës së Apelit.

2. Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar rregullohet nga Kodi i Procedurës Civile dhe nga Konventa për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, bërë më 10 qershor 1958 në NjuJork, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar nëpërmjet ligjit nr.8688, datë 9.11.2000, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”.

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 53

Dispozita kalimtare

1. Vlefshmëria e marrëveshjeve të arbitrazhit të nënshkruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji përcaktohet sipas legjislacionit të zbatueshëm në momentin e nënshkrimit të tyre.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për procedurat e arbitrazhit që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë shprehimisht dakord ndryshe.

3. Procedurat që janë në pritje përpara gjykatave në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë sipas legjislacionit të zbatueshëm përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 54

Shfuqizime

1. Çdo dispozitë ligjore dhe nënligjore që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohet në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 55

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

[SHQIPTARJA.COM]